



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË
KIBERNETIKE

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2019

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ushtron veprimtarinë e tij, në zbatim të ligjit 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, ligjit nr.107/ 2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” dhe ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve të besuara dhe sigurisë kibernetike.

Bazuar gjithashtu në VKM 141, datë 22.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të veta, veprimtaria e këtij institucioni është konkretizuar me realizime detyrash, si më poshtë:

1. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 173, datë 09.11.2018, “Për ngritjen e grupit ndër institucional të punës, për hartimin Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike”, grupi i punës nën drejtimin e AKCESK ka hartuar draftin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025, së bashku me Planin e Veprimit dhe Pasaportën e Indikatorëve, i cili do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Në zbatim të Ligjit Nr.2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”, dhe VKM-së Nr. 222, datë 26.04.2018, “ Për Miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit ”, është bashkërenduar puna me sektorin privat të shëndetësisë, subjektet jo banka dhe shoqëritë e sigurimeve, si potencial operatorësh që disponojnë infrastruktura informacioni me të dhëna sensitive. Nga ky bashkëpunim, këto infrastruktura janë identifikuar si infrastruktura kritike dhe të rëndësishme dhe është duke u draftuar akti për ndryshimin e VKM-së së sipërpërmendur, duke i shtuar këto tek lista aktuale e miratuar.
3. Janë kryer auditet për implementimin e masave të sigurisë nga Operatorë e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit (6 subjekte), si dhe është koordinuar puna me 18 OIK dhe OIR, duke kryer procesin e vetë deklarimit mbi plotësimin e këtyre masave.
4. Është koordinuar dhe bashkërenduar puna me ISP-të si dhe institucionet publike, me qëllim përmirësimin e procesit të raportimit dhe bllokimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme në Portalin Online, që administrojnë AKCESK.

5. Në kuadër të projektit “ Ngritja e kapaciteteve në institucionet e drejtësisë penale në luftën kundër krimit kibernetik në Evropën Jug-Lindore” të OSBE është zhvilluar një trajnim një javor për punonjësit e Policisë së Shtetit pranë Akademisë së Sigurisë.
6. Hartimi i “Rregullores për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike”.
7. Hartimi i “Manual për Procedurën e Auditit në Infrastrukturat Kritike të Informacionit dhe Infrastrukturat e Rëndësishme të Informacionit”.
8. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional është firmosur Marrëveshja e Mirëkuptimit me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me qëllim mbështetjen operacionale dhe teknike në fushën e sigurisë kibernetike.
9. Është hartuar dhe miratuar “*Udhëzimi mbi administrimin e sistemit të “Menaxhimit të raportimit të incidenteve të sigurisë kibernetike”*”(Konfidencial)
10. Është koordinuar puna me Bankat e nivelit të dytë, mbi mënyrën e përdorimit të sistemit të “Menaxhimit të raportimit të incidenteve të sigurisë kibernetike”, për proceset: e aksesimit; personat përgjegjës; afatet e raportimit; llojet dhe kategorizimi i incidenteve që duhen raportuar, etj.
11. Në kuadër të ditës botërore të Internetit të Sigurtë, Autoriteti në bashkëpunim Ministrinë e Arsimit dhe Rinisë, UNICEF Albania, organizuan në shkollën “Kosova” aktivitetin me fokus ndërgjegjesimin e fëmijëve për përdorimin e internetit të sigurt dhe bashkëpunimin institucional, për zgjidhjen e problemeve në lidhje me dhunën online, bullizmin, shfrytëzimin seksual, si dhe abuzimin në internet etj...
12. Në partneritet me Unicef Albania, Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, AKCESK zhvilloi fazën e II-të të trajnimeve për rritjen e ndërgjegjesimit dhe edukimin e fëmijëve mbi përdorimin e internetit të sigurtë. Gjithsej gjatë fushatës janë trajnuar 312 “peer educators” dhe rreth 15 000 nxënës të shkollave 9-vjecare, në nivel kombëtar.
13. Në bashkëpunim me Forumin Evropian të Autoriteteve Mbikëqyrëse të Ofruesve të Shërbimeve të Besuara (FESA) dhe European Union Agency for Cybersecurity (ENISA) organizoi takimin e radhës në Tiranë me të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian.
14. Është kryer kontrolli/inspektimi periodik në zyrën qendrore (PKI) dhe në 82 zyra të ALEAT për mbikëqyrjen e veprimtarisë në tërësi, mbi përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike për lëshimin e certifikatave të kualifikuara nga ky Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar. Gjithësej për vitin 2019 nga ALEAT, janë lëshuar 812600 Certifikata të kualifikuara për qytetarët dhe janë kryer 82817 transaksione të suksesshme me autentifikimin elektronik/ nënshkrim elektronik në bankat e nivelit të dytë.
15. Është kryer kontrolli/ inspektim periodik i Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, për mbikëqyrjen e veprimtarisë në rolin si Ofrues i Kualifikuar i

Shërbimit të Besuar (OKSHB). Gjithësej nga ky OKSHB janë lëshuar rreth 3000 Certifikata të kualifikuara për administratën publike dhe subjekte private.

16. Në bashkëpunim me AKSHI-n, në Korrik të këtij viti AKCESK zhvilloi edicionin III të Albanian Cyber Academy. Ky event i përvitshëm, synon rritjen e kapaciteteve nëpërmjet thellimit të njohurive në fushën e sigurisë kibernetike për studentët e TIK. Modulet e trajnimeve hartohen dhe zhvillohen nga ekspertë ndërkombëtare të fushës në bashkëpunim me stafin e AKCESK.
17. Në zbatim të legjislacionit për sigurinë kibernetike, me cilësinë e CSIRT-it kombëtar, AKCESK ka organizuar trajnime për rritje kapacitetesh të CSIRT-eve sektoriale, nëpërmjet stërvitjeve kibernetike, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit në nivel kombëtar.
18. Në kuadër të muajit të sigurisë kibernetike, në datën 21 Tetor 2019, u organizua konferenca “WOMEN IN TECH”, me në fokus gruan dhe karrierën e saj, me qëllim motivimin dhe këshillimin për përfshirje më të gjerë të tyre në fushën e teknologjisë së informacionit.
19. Janë zhvilluar trajnime specifike për rritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale në fushën e Sigurisë Kibernetike si dhe Shërbimeve të Besuara të stafit të Autoritetit në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare si: NATO, OSBE, Dcaf, etj...
20. Janë përmbushur detyrimet sipas angazhimeve të marra ndaj NATO dhe OSCE, në nivel kombëtar, me cilësinë e institucionit koordinues dhe si pikë kontaktit për institucionet publike vendase dhe organizmat ndërkombëtarë